

Pershendetje znj. Goce

Bashkelidhur si me poshte pergjigja per gazetaren e TV Tema:

Së pari, ju paraqesim një përshkrim të bazës ligjore dhe rregullatore për këtë çështje:

Bazuar në pikën 1, të nenit 2, të Ligjit Nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, AKEP nuk ka kompetencë ligjore të shqyrtojë përmbajtjen e komunikimeve elektronike, pra nuk ka kompetencë të shqyrtojë as përmbajtjet e faqeve të internetit.

Përmbajtja faqeve të internetit, shqyrtohet dhe vlerësohet nga institucione të tjera ligjzbatuese, siç janë Autoriteti i Mediave Audiovizuale, Autoriteti i Mbikqyrjes së Lojrave të Fatit, Prokuroria, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK), etj, në varësi të përcaktimeve të Ligjore dhe ligjeve specifike me të cilat funksionojnë këto institucione.

Këto institucione, kur konstatojnë shkelje legjislacioni me përmbajtjet e faqeve të internetit, i drejtohen AKEP, për të kërkuar nga ofruesit e shërbimit internet (ISP) mbylljen e URL (link) specifike ose të gjithë domainit të faqes së internetit.

Në germën e) të nenit 15 të Ligjit Nr.9918, dhe në germën e), pika 1, e nenit 9, si dhe pikën 9 të Aneksit E, të Rregullores së AKEP nr. 47 datë 26.10.2017 “Për zbatimin e regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm”, përcaktohet që :

-çdo operator/sipërmarrës që ofron shërbime/rrjete të komunikimeve elektronike, duhet të marrë masa për kufizimin e transmetimeve të përcaktuara me përmbajtje të paligjshme ose të dëmshme.

Në Rregulloren nr. 47, te cituar me sipër, AKEP ka përcaktuar që me disponimin e kërkesës së organit kompetent të fushës për kufizimin e transmetimit me përmbajtje të paligjshme ose të dëmshme, i drejtohet sipërmarrësit (në këtë rast ISP-ve), për bllokimin e aksesit ne internet, te faqes sipas specifikimeve te sjella nga organi pergjegjes qe e ka shqyrtuar qe faqja ka permbajtje te paligjshme ose te demshme.

Lidhur me pyetjet tuaja, pergjigjet jane si me poshte:

-Informacion lidhur me numrin e faqeve pornografike në Shqipëri (veçanërisht ato ndaj fëmijëve) dhe si veprohet për mbylljen e aktivitetit të tyre.

Për sa kemi sqaruar më sipër, AKEP nuk ka informacion për numrin e faqeve pornografike në Shqipëri apo atyre jashtë Shqipërisë që hapen/aksesohen brenda Shqipërisë nëpërmjet internetit, për arsye se AKEP nuk është institucioni përgjegjës për vlerësimin e këtij informacioni.

- A ka pasur rritje të numrit të këtyre faqeve në Shqipëri gjatë kësaj periudhe?

AKEP nuk disponon informacion të tillë dhe ju sugjeron tu drejtoheni Autoriteteve kompetente, të sipërcituara.

- Si veproni për “mbajtjen” nën kontroll të këtyre faqeve apo/dhe mbylljen e tyre?

Meqenëse AKEP nuk ka kompetencë ligjore për të shqyrtuar përmbajtjen e faqeve të internetit, si rrjedhojë nuk mund të “mbajë” nën kontroll këto faqe.

AKEP vepron konform përcaktimeve ligjore të sipërcituara, vetëm nëse i paraqitet kërkesë/vendim nga institucionet që kanë të drejtë shqyrtimin e përmbajtjeve të këtyre faqeve, për tju drejtuar ISP për bllokimin e aksesit në internet të këtyre faqeve.

- Nëse ju vjen një “denoncim” për të mbyllur një faqe të caktuar, ju mbyllni vetëm atë faqe, por edhe faqe të ngjashme me të?

Nëse denoncimi vjen nga individë apo shoqëri, që kërkojnë mbyllje URL/domainesh të ndryshme, AKEP u rekomandon të drejtohen institucioneve përgjegjëse që kanë kompetencë të shqyrtojnë përmbajtjen e paligjshme apo të pademshme të faqeve të internetit.

Dhe me pas nëse këto organe e gjykojnë të paligjshme përmbajtjen e faqes, i drejtohen AKEP që tu drejtohet ISP për bllokimin e aksesit në internet.

Duke ju falenderuar